



Pranuar / Dorezuar Puniljeno / Prodato Received / Delivery	29.12.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojt Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHAK	7735/2023		1/9



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.530/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1801/2021, të datës 28.09.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.530/2021 të datës 11.06.2021, të parashtruar nga ankuesja

me adresë banimi kundër organit të punësimit/ Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e jashtafatshme ankesa me numër A.nr.530/2021, e datës 11.06.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja sipas marrëveshjes me numër 09-06-1593 të datës 30.05.2016, të lidhur nga Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës është transferuar nga pozita Koordinatore e Seancave - Divizioni administrativ i ish bordit të pavarur për rishqyrtim /Ministria e Financave në pozitën "Zyrtare Ligjore" në Divizionin Ligjor të Administratës Tatimore të Kosovës për shërbime juridike. E njëjta me datë 31.05.2016 e ka nënshkruar Akt emërimit me numër Nr.Prot.11/999/11 për pozitën „Zyrtare për Përfaqësim Ligjore” në Divizionin për Përfaqësim dhe Bashkëpunim Ndërinstitucional / Drejtoria Shërbimet Juridike në Administratën Tatimore të Kosovës me koeficient tetë (8).

Me datën 28.12.2018, ankueses i 'u është bërë ndryshimi dhe plotësimi i Akt emërimit konkretisht titulli i pozitës nga „Zyrtar Ligjor” në „Zyrtar i Lartë Ligjor” në

Divizionin për Përfaqësime dhe Bashkëpunim Ndërinstitucional/Departamenti për Shërbime Juridike, në Administratën Tatimore të Kosovës duke filluar nga data 01.01.2019.

Njësia e Burimeve Njerëzore disa herë ka parashtruar kërkesë tek Divizioni i Pagesave që ankueses ti ngritët koeficienti nga 8 në 8.5, marrë parasysh qëllimin se puna e njëjtë paguhet njëjtë dhe se të gjithë zyrtarët ligjore në ATK e kanë koeficientin 8.5. Divizioni i Pagesave në muajin maj të vitit 2020 ka realizuar ndryshimin e koeficientit nga 8 në 8.5 për ankuesen.

Ankuesja me datën 12.04.2021, përmes e-mailit zyrtar i është drejtuar Kryetarit të Sindikatës së Administratës Tatimore të Kosovës, ku ka kërkuar nga ky i fundit që të kontribuojë në këtë çështje duke reaguuar dhe kërkuar nga personat kompetent që ti realizohet kompensimi në mënyrë retroaktive sipas koeficientit të ri 8.5 për pozitën „Zyrtare e lartë ligjore“ në Administratën Tatimore të Kosovës nga data 01.01.2019 deri në muajin prill 2020.

Menaxherja e Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës me datë 03.06.2021, përgjigjet në kërkesën e datës 12.04.2021 të Kryetarit të Sindikatës së Administratës Tatimore të Kosovës lidhur me pagesën retroaktive sipas koeficientit të ri 8.5 për pozitën „Zyrtare e lartë ligjore“ në Administratën Tatimore të Kosovës nga data 01.01.2019 deri në muajin prill 2020, përmes se cilës e njofton se nuk ka bazë ligjore për kompensim e së njëjtës në mënyrë retroaktive.

E pakënaqur me mos realizimin e pagesës retroaktive nga ana e Administratës Tatimore të Kosovës, ankuesja me datën 11.06.2021, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3025/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 14.06.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa Këshilli me datën 22.06.2021, ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga data 30.06.2021, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa me datën 26.07.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe e ka udhëzuar se mund të ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloj procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datën 28.09.2023 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.1801/2021, i cili në Këshill është pranuar me datën 09.10.2023, sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 26.07.2021, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për ankesën e datës 11.06.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova; Ankesën me numër të protokollit 3025/2021 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit të ankueses i datës 28.12.2018; Akt emërimi i ankueses i datës 31.05.2016; E-maili zyrtar i datës 03.06.2021; E-maili

zyrtar i datës 22.04.2021; E-maili zyrtar i datës 12.04.2021; E-maili zyrtar i datës 26.03.2021; E-maili zyrtar i datës 04.02.2021; E-maili zyrtar i datës 27.01.2021; E-maili zyrtar i datës 29.01.2020; E-maili zyrtar i datës 11.12.2019; E-maili zyrtar i datës 11.12.2019; E-maili zyrtar i datës 08.11.2019; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 14.06.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 22.06.2021 nga Administrata Tatimore e Kosovës me shkresat e bashkangjitura; Marrëveshje e datës 30.05.2016; Akt emërim i ankueses i datës 31.05.2016; Formulari për përshkrimin e detyrave të punës së ankueses i datës 20.06.2012; Kërkesë e datës 10.02.2020; Formular i të dhënave për listën e pagave i datës 10.02.2020; Formular i të dhënave për listën e pagave i datës 06.03.2020; Formular i të dhënave për listën e pagave i datës 31.03.2020; Formular i të dhënave për listën e pagave i datës 08.05.2020; E-maili zyrtar i datës 26.07.2021; Qarkore administrative Nr.01/2016 e datës 22.01.2016; Titujt e vendeve të punës të plotësuar dhe ndryshuar në katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil të Kosovës e datës 21.02.2018.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses është **jashtë afatit ligjor, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit dhe ka konstatuar se ankuesja në bazë të ndryshimit dhe plotësimi të Akt emërimit të datës 28.12.2018, lidhur me pozitën „Zyrtar i Lartë Ligjor” e ka nënshkruar me datë 08.02.2019, ndërsa e njëjta që nga data 08.02.2019 prej kur e ka nënshkruar Ndryshimin dhe plotësimin e Aktit të emërimit, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ligjor deri me datën 11.06.2021 me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill, respektivisht ankuesja nuk ka ofruar as një dëshmi që ka parashtruar ankesë në kuadër të institucionit të punësimit po ashtu një gjë të tillë e ka konfirmuar edhe organi i punësimit me rastin e kthimit të përgjigjes në ankesë për Këshillin me datë 22.06.2021. Kështu që nisur nga faktet e mësipërme, Kolegji ka konstatuar se ankuesja ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (i aplikueshëm nga data 10.07.2010 deri me datë 09.07.2020) si dhe nenit 8 paragrafit 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave ku përcaktohet se: **„Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”,** akte këto të aplikueshme në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në kohën e emërimit sipas aktit të emërimit të ankueses të datës 28.12.2018.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimin ankimor të ankueses për kompensimin në mënyrë retroaktive të ndryshimit të koeficientit nga 8 ne 8.5 për pozitën „Zyrtare e lartë ligjore” duke filluar nga data 01.01.2019 deri ne muajin prill 2020, ka konstatuar se ankuesja me datë 08.02.2019 e ka nënshkruar ndryshimin dhe plotësimin e Akt emërimit të datës 28.12.2018, ndërsa me datë 11.06.2021 e njëjta ka parashtruar ankesën me numër protokolli 3025/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vlerëson se ankesa për kompensimin në mënyrë retroaktive ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil te Kosovës është parashtruar **jashtë afatit ligjor** gjegjësisht në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht me nenin 127 paragrafin 1 dhe 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”** në rastin konkret ankuesja nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimit për realizimin e pagesës retroaktive në pajtim me nenin 127 paragrafin 1 dhe 4 të Ligjit Nr.05, /L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative .



Andaj, duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.530/2021.

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.